



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2206/11 Prot

Rrëshen, më 29 . 05 . 2026

V E N D I M

Nr. 36 datë 26. 05. 2026

P Ë R

**“MIRATIMIN E ANEKSEVE TË MONITORIMIT, TË BUXHETIT, 4 – MUJORI
(JANAR - PRILL), VITI 2026”, BASHKIA MIRDITË**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ligji nr. 68/2017, pika 3, neni 48, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligji nr. 87/2025, “Për buxhetin e vitit 2026”, Udhëzimin nr. 9, datë 20. 07. 2018, i Ministrisë Financave dhe Ekonomisë, “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, në Udhëzimin nr. 22, datë 30.07.2018, “Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit të njëjësive të vetëqeverisjes vendore”, pika 48, dhe formateve të aneksit 1 dhe 2, bashkëlidhur, Udhëzimin nr. 2, datë 14.01.2026, “Për zbatimin e buxhetit 2026”, Vendimin nr. 98, datë 10.12.2025, të Këshillit Bashkiak Mirditë, “Për miratimin e buxhetit të vitit 2026”, Vendimin nr. 22, datë 19.03.2026, të Këshillit Bashkiak Mirditë, “Për miratimin e fondeve të trashëguara nga buxheti i vitit 2025, për buxhetin e vitit 2026”, *Relacion mbi realizimin e shpenzimeve dhe të ardhurave të 4-mujorit të Parë, vitit 2026; (nr. 2205 prot, datë 18.05.2026)*, së bashku me projekt-vendimin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë, *pas shqyrtimit dhe miratimit, në mbledhjen e datës 25.05.2026, të Komisionit të Ekonomisë, Financave dhe Buxhetit*, për t’ia kaluar në mbledhjen e Këshillit Bashkiak, pas diskutimeve;

V E N D O S I:

1. Të miratojë anekset e monitorimit të buxhetit, 4-mujori (Janar - Prill), vitit 2026, Bashkia Mirditë, *(bashkëlidhur, Relacioni mbi realizimin e shpenzimeve dhe të ardhurave të 4-mujorit të Parë, vitit 2026; (nr. 2205 prot, datë 18.05.2026) dhe tabelat, pjesë përbërse e këtij vendimi*
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë; (Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Tatim Taksat)

Ky vendim, hyn në fuqi, sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar, dhe pas konfirmimit ligjor, nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë.

SEKRETAR

Gaspër TOPOLLAJ



KRYETAR

Aleksandër PICAKU

ADRESA: SHESHI “ABAT DOÇI”, RRËSHEN

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel dhe fax : (00355) (0) 2162233

www.bashkiamirdite.gov.al